



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo



**Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority**

Numër: 01-636

Datë: 25.06.2026

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Nr.35-2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen II-t dhe të III-t e mbajtur me datë 25.06.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

Riakreditohet dhe rivalidohet institucioni "Akademia e Kosovës për Siguri Publike-AKSP", me adresë: Rr: Gjergj Kastrioti Skënderbeu, Vushtrri, Republika e Kosovës, për periudhën pesë (5) vjeçare, përkatësisht nga data 24.07.2024 deri 24.07.2029, me kualifikimin e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

- 1.1 Zyrtar Policor**, Niveli V sipas KKK, Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 75 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e Aftësimit Profesional me më së shumti dy (2) gjenerata brenda vitit, në numrin e kandidatëve të përcaktuar maksimalisht 500 (pesëqind) kandidatë/kadet. Grupet brenda gjeneratës përkatëse duhet të ndahen nga koordinatoret e programeve dhe sipas nevojës, ashtu siç përcakton kurrikula përkatëse. Fillimi i të dyja gjeneratave mund të behët brenda Vitit, por jo në të njëjtën kohë,
- 1.2 Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës**, Niveli V sipas KKK, Loji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 82 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me më së shumti dy (2) gjenerata/grupe brenda vitit, duke përfshirë 30 kandidatë për gjeneratën përkatëse. Fillimi i të dyja gjeneratave mund të bëhet brenda vitit, por jo në të njëjtën kohë.
- 1.3 Zyrtar Doganor**, Niveli IV sipas KKK, Iloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 55 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me njëzetepesë (25) kandidat në dy grupe paralele, dhe gjatë një

viti mund të mbahen dy cikle të tilla që në total i bie njëqind (100) kandidate për një vit akademik.

1.4 Zjarrfikës, Niveli IV sipas KKK, lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 40 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit me njëzetepesë (25) kandidat në tri (3) grupe, që në total i bie shtatëdhjetepesë (75) kandidate për një vit akademik.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së Akademia e Kosovës për Siguri Publike-AKSP, për ri validim, ri akreditim dhe rekomandimeve të dala nga raportet e vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi ri validimin e kualifikimit, si dhe raportet e ekipit të ekspertëve mbi ri akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 01.04.2026 për kualifikimin: ZYRTAR POLICOR– NIVELI -5 SIPAS KKK dhe INSPEKTOR I INSPEKTORATIT POLICOR– NIVELI -5 SIPAS KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 03.04.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 26.05.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të datës 29.05.2026 dhe 25.06.2026

Ekipi i ekspertëve pas shqyrtimit të dosjes së aplikimit 02.04.2026 për kualifikimin: ZYRTAR DOGANOR– NIVELI -5 SIPAS KKK ndërsa vizita është realizuar me datën 03.04.2026. Pas përfundimit të procesit vlerësues, raportet janë realizuar me datë: 22.05.2026, Bazuar në analizimin e dosjes së aplikimit dhe të gjeturat me rastin e realizimit të vizitës si dhe raportet vlerësuese të ekipeve të ekspertëve janë proceduar për vendimmarrje në mbledhjen e Këshillit Drejtues të mbledhjes së II-te e mbajtur me datë 29.05.2026 dhe të mbledhjes së III-te e mbajtur me datë 25.06.2026

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për ri akreditim ka marrë parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për ri akreditimin e kualifikimit si dhe kohën e shqyrtimit të dosjes së aplikimit, nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për ri validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për ri akreditim si institucion ofrues dhe/ose

vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Këshilli Drejtues i AKK-së gjatë vendimmarrjes për ri akreditim ka marr parasysh faktin se institucioni kishte aplikuar brenda afatit ligjor për ri akreditimin e kualifikimit si dhe kohën e shqyrtimit të dosjes së aplikimit, nga momenti i dorëzimit të kërkesës.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Akademia e Kosovës për Siguri Publike-AKSP

2. Arkivit të AKK-së.

Dr. Besim MUSTAFA


Kryetar KD së AKK

